

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT” për 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore 90524400-0.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: 1,409,700 (një milion e katërqind e nëntë mijë e shtatëqind) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “*Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, në të cilën është e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi:Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020“ Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori ekonomik duhet të ketë Leje Mjedisi sipas Ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi sipas Ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 **Leje Mjedisi të Tipit A (Kat. 5.1.a) ose ‘Leje Mjedisi e Tipit B** (stacion transferimi mbetjesh te rrezikshme)’, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, e lëshuar nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit.

b) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisi sipas Ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 **Leje Mjedisi të Tipit B (stacion trasferimi mbetjesh t; rreyikshme)** i ndryshuar e leshuar nga Ministria e Turiymit dhe Mjedisit e vlefshme në momentin e hapjes së tenderit. *E aplikushme në rast së subjekti i trajton mbetjet jashte territorit të Republikës së Shqipërisë.*

c)

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 te Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germen a pika 4 te nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”, si dhe *Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar*, si dhe Shkreses te Komisionit te argumentimit **nr. 870/6 prot, datë 05/05/2023** “Relacion per argumentimin e fondit limit dhe specifikimet teknike”, bazuar në urdhërin e Titullarit të Përgjithëm nr.231, me nr. 870/1 prot., datë 28/04/2023”.

d) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën **ISO 9001:2015**, certifikatë e menaxhimit të cilësisë. Kjo certifikatë është e vlefshme për grumbullimin, transportimin, trajtimin e mbetjeve spitalore dhe medikamenteve, dezinfektim të mjedisit spitalor, industrial dhe ushqimor.

Sqarim: “dezinfektimi mjedisit spitalor, industrial dhe ushqimor” e cituar në ISO-t e kërkuara, është pjesë e emërimit të certifikatave dhe pikave kyçe të vlefshmerisë së tyre dhe nuk është kërkesë specifike konkrete nga A.K. që duhet të zbatohet nga O.E.

e) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën **ISO 14001:2015**, certifikatë e sistemit të menaxhimit të mjedisit. Kjo certifikatë është e vlefshme për grumbullimin, transportimin, trajtimin e mbetjeve spitalore dhe medikamenteve, dezinfektim të mjedisit spitalor, industrial dhe ushqimor. *Sqarim: “dezinfektimi mjedisit spitalor, industrial dhe ushqimor” e cituar në ISO-t e kërkuara, është pjesë e emërimit të certifikatave dhe pikave kyçe të vlefshmerisë së tyre dhe nuk është kërkesë specifike konkrete nga A.K. që duhet të zbatohet nga O.E.*

f) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën **OHSAS 18001:2007** mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” ose **ISO 45001:2018**. *Sqarim: “dezinfektimi mjedisit spitalor, industrial dhe ushqimor” e cituar në ISO-t e kërkuara, është pjesë e emërimit të certifikatave dhe pikave kyçe të vlefshmerisë së tyre dhe nuk është kërkesë specifike konkrete nga A.K. që duhet të zbatohet nga O.E.*

Shënim: Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike secili prej operatoreve duhet të përmbushë kriteret ligjore të kërkuara me sipër.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjë mbeshtetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjë mbeshtetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera e tyre të jo më e vogël se **40 % e vlerës së fondit limit**.

*Shënim**: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10

Nëse operatorët ekonomikë, që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...],* në piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: **Pika 1:** Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. **Pika 2/b: b)** vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; **Pika 2/b: ...2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;** Duke qenë se kjo procedurë prokurimi bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. AK është qendër spitalore terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi. AK ka parashikuar vlerën prej 40 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, duke qenë se objekti i kontratës është specifik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatese te shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/te tyre, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenin 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; ne piken 3 te nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]3. . Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, si dhe ne piken 4 te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...] 4. Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: pika b: Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, piken 3 te nenit 41, si dhe ne germen b) pika 4 e nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU “Nënë Tereza” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të deklarojë që kudo që të jetë e mundur, këto mbetje duhet të incenerohen. Operatori ekonomik deklaton se mbetjet objekt prokurimi nuk duhet të dërgohen në landfill apo të shkarkohen në sistemin e kanalizimit.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të përcaktohet Këshilltari i Sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, së bashku me certifikatë të vlefshme të formimit profesional të tij, këshilltari i sigurisë duhet të jetë në marrëdhënie pune të vërtetuar me operatorin ekonomik (vërtetuar me kontratë ndërmjet palëve).

- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të deklarojë se trajtimi i mbetjeve, objekt prokurimi do të zbatohen sipas specifikimet teknike sipas shtojcës nr. 5 të DST.
- d) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një autodeklarate ku të deklarohet se të gjitha materialet që do të përdoren për ambalazhim dhe trajtimi i mbetjeve janë të miratuara nga Institucionet përkatëse sipas dispozitave të ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” dhe VKM Nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore" ose sipas kushteve të përcaktuara të ambalazhimit “ADR” (Miratuar me ligjin nr. 9272, datë 16.09.2004 “Për aderimin e RSH në Marrëveshjen Europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”.
- e) Operatori duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të specifikojë nëse mbetjet objekt prokurimi do të trajtohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë kufijve të saj. Në rastet e trajtimit brenda territorit, në autodeklaratë duhet të pasqyrohet vendi ku do të bëhet asgjësimi i mbetjeve objekt i kësaj kontrate, për rastet e eksportit ndërkombëtar të mbetjeve, operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Autorizim për eksport të mbetjeve, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për mjedisin (MTM) sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve”, vlefshmëria e të cilit duhet të mbulojë vlefshmërinë e kontratës. Në rastin kur OE nuk është i pajisur me Autorizim, duhet të deklarojë afatin maksimal brenda të cilit mund të pajisjet me autorizim në rast se shpallet fitues.
- f) Kur mbetjet do të trajtohen/asgjesohen brenda Territorit të RSH, OE ofertues, duhet të ketë në pronësi ose me qera impiant për trajtimin e mbetjeve spitalore për të përballuar sasinë e mbetjeve të parashikuar në shtojcën 5 të DST, 3700 kg për periudhën e parashikuar në DST, sipas Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore (*për mbetjet citotoksike*). Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë lejen mjedisore të impiantit të lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (të vlefshme), ku të parashikohet trajtimi i mbetjeve objekt prokurimi si dhe certifikatën e pronësisë ose kontratën e qirasë për të provuar disponimin e impiantit:

Në rast eksporti të këtyre mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe liçensa ADR për transport të mbetjeve të rrezikshme, duke u referuar në Konventën e Bazelit, operatori ekonomik duhet të ketë Autorizimet përkatëse. Gjithashtu kur mbetjet nuk i trajton mbetjet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë duhet të deklarojë se do mbajë mbajë proces verbal për etapën e parë të punës që është ndarje, klasifikim, mbledhja, paketimi i mbetjeve, si edhe etapa e dytë e ngarkimit, transportit, eksportin e mbetjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të Shkresës shkresës nr.870/7 prot., datë 10.05.2023 “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, bashkëlidhur me shkresën nr. 870/6 prot., datë 05.05.2023 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë për 12 muaj**, “Argumentimi i Nevojave, Specifikimeve teknike dhe Llogaritjen e Fondit limit “Trajtim

dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë për 12 muaj”, me Urdhër të Titullarit të Përgjithshëm me Nr.231 (nr.870/1 prot.), datë 28.04.2023, për nevojat e QSUNT për 12 muaj, u argumentua/hartuar nga anetaret e Njesise se Prokurimit që kanë specialitetet përkatëse në lidhje me kriteret teknike, si kriter i vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në pikën 5/b/c të nenit 40, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Për këtë procedurë objekti i prokurimit është: Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë për 12 muaj. Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrë e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Ky kriter është miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit që kanë specialitetin përkatës në lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter mbështetet edhe në Rekomandimin e APP Nr. 8197, datë 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit mallra, punë, shërbime”. Ky kriter gjen mbështetje në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” dhe VKM Nr.798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të ndryshuar. Gjithashtu këto kriter janë miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit që kanë specialitetin përkatës në lidhje me kriteret teknike, në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, VKM nr. 295, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Njoftimi i APP-së, me nr.2502prot., datë 09.04.2021, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise se përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”, të Ligjit me Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar me ligjin Nr.60/2014 datë 19.06.2014, si dhe konventën e Baselit 1989, si dhe rregullores Europiane 1013/2006.

h) Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Lloji i makinerise (pajisjes)	Njesia	Sasia
Automjet të posaçëm* , të pajisur me sinjalistikën përkatëse për transport mbetjesh të rrezikshme spitalore	Copë	1
Peshore e çertifikuar	copë	1

- Për automjete që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (çertifikatën e pronësisë, leje qarkullimi (lëshuar nga DPSHTRR), Akt kolaudimi SGS (i vlefshëm), Siguracion të vlefshëm, taksat vjetore (DPSHTRR), Në rast eksporti të mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe çertifikatë trajnimi profesional ADR për shoferin që do të drejtojë mjetin e kërkuar, për transport mallrash të

rrezikshme, të vlefshem, si dhe çertifikaten e pronësisë së mjetit së bashku me kontratën e qirasë kur mjete është i marrë me qira.

- Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë së Republikës së Shqipërisë, që do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik.

***Sqarim:** Mjeti i kërkuar si më sipër, duhet të jetë sipas përshkrimit: “**plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar**”, sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni: 9.3.3 ‘**Atomjetet/anijet e grumbullimit**’; Gjithashtu automjeti duhet të plotësojë edhe kriteret e pikës 8.8/c dhe shtojcën 4 të VKM nr.798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

i) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autodeklaratë, ku të deklarojë që do plotësohen të gjitha specifikimet teknike për këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me germenin ç) pika 4 të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Ky kriter mbështetet edhe në Rekomandimin e APP Nr. 8197, datë 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit mallra, pune, shërbime”.

Ky kriter është plotësuar në bazë të volumit të shërbimeve sipas zerave të shërbimeve, të përcaktuara në preventivin e shërbimeve, mjetet dhe pajisjet teknike të mësipërme, janë përcaktuar në përputhje me listën e shërbimeve. Pra janë vendosur kërkesa të cilat lidhen ngushtë aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Mjetet dhe pajisjet teknike, janë kërkuar nga AK për t’u siguruar në aftësitë teknike për zbatimin korrekt të shërbimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë për 12 muaj.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT” për 12 muaj.	Kg	3700

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. Operatori ekonomik, duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.
2. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të QSUNT. Për kryerjen e shërbimit operatori ekonomik duhet të paraqesë në periudha kohore mujore përkatëse, situacionin përmbledhës, faturat shoqëruese për sa është realizuar, proces-verbal për shërbimin e kryer, printimet e impiantit të trajtimit, dokumentacion vërtetues/ fletë shoqëruese për dorëzimin e hirit.
3. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e të dy palëve, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUNT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Ambalazhimi (kutitë, fuçitë, paletat, etj.) do të mbulohet nga subjekti fitues.
4. Tërheqja dhe peshimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do bëhet periodikisht ë përcaktuar nga AK, dhe sa herë AK ka nevojë, në vendin e përcaktuar nga ky i fundit si dhe pagesa do të bëhet në bazë të kilogramëve të tërhequra sipas proces-verbaleve të firmosur nga të dyja palët. Pas evadimit të mbetjeve Operatori duhet të realizojë dezinfektimin e ambientit, të pasqyruara me proces-verbal.
5. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik.
6. Subjekti duhet të furnizojë AK sa herë që kryen evadimin e mbetjeve ose cdo fillim muaji me kontenierë njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmase (sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore.

7. Marrësi në dorëzim, cdo muaj, i dërgon dorëzuesit (QSUNT) një konfirmim me shkrim për realizimin e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, bashkëlidhur dhe kopje të pritimeve të impiantit të trajtimit

8. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit

9. Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht një makinë të vërtetuar me certifikatë pronësie dhe të ketë sinjalistikën përkatëse për transport të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe të jetë i pajisur me leje për transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

10. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve. Dokumenti i transferimit të mbetjeve, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a. numrin e dokumentit të dorëzimit;
- b. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;
- c. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
- ç. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
- d. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;
- dh. përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasitë respektive;
- e. hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimet e tyre.

11. O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit dhe për këtë të dorëzojë cdo muaj, pranë sektorit, dokumentacion vërtetues/ fletë shoqëruese të dorëzimit të hirit pranë subjektit të licensuar.

12. Subjekti duhet të ketë **Leje Mjedisi të Tipit A (Kat. 5.1.a)** sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, e lëshuar nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe **License III.2.B** të lëshuar nga QKB për Trajtim mbetje spitalore.

13. Subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën **ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018.**

Në rast së subjekti i trajton mbetjet jasht territorit të Republikës së Shqipërisë:

1. **Leje Mjedisi e Tipit B (stacion transferimi mbetjesh të rrezikshme)**, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, lëshuar nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit.

2. Në rastë së subjekti nuk i trajton mbetjet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë duhet të mbajë proces verbal për etapën e parë të punës që është ndarje, klasifikim, mbledhja, paketimi i mbetjeve, si edhe etapa e dytë e ngarkimit, transportit, eksportin e mbetjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Në rast eksporti të këtyre mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe liçensa ADR për transport të mbetjeve të rrezikshme. Në rast mundësie të transportit ndërkombëtar, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke u referuar në Konventën e Bazelit, subjekti duhet të ketë Autorizimet përkatëse.

4. Ndarja-Klasifikimi-Paketimi-Etiketimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do bëhet në fuçi dhe/ose thasë, dhe /ose kontenier, 1A2 approved, të etiketuara me shenjën e mbetjeve citostatike citotoksike, sipas procedurave të miratuara nga BE. Gjithashtu duhet të etiketohen dhe markohen sipas direktivave të ADR "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme", nga personeli i firmës që do të bëjë asgjësimin e tyre.

5. Mbetjet citostatike dhe citotoksike do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve, ku do hartohet procesverbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Pas peshimit, mbetjet ambalazhohen në kutitë përkatëse për t'u transportuar nga operatori.

6. Ngarkimi në kamion do të supervizohet nga një inxhinier i fushës, staf i firmës si dhe personat përgjegjës të QSUNT.

7. Transporti do të realizohet pas miratimit të lejes së lëvizjes ndërkufitare nga autoritetet përkatëse në Shqipëri dhe në vendin ku do të eksportohen këto mbetje.

8. Autorizimet e eksportit, për trajtimin e këtyre mbetjeve duhet të jenë të miratuara nga Ministritë e Mjedisit të të dyja palëve të vëndeve dhe do të jenë në përputhshmëri me konventën e Baselit 1989, si dhe rregullores Europiane 1013/2006.

9. Të gjitha dokumentacionet doganore do të jenë përgjegjësi e subjektit.

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT” për 12 muaj.

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia
1	“Trajtim dhe asgjësimit të mbetjeve citostatike dhe citotoksike në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza” (për 12 muaj).	Kg	3700

Afatet e ekzekutimit: **Nga data e lidhjes së Marrëveshjes Kuadër për një afat 12 muaj, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.**

Shënim: Lidhja e kontratave brenda Marrëveshjes Kuader do të bëhet sipas kërkesës së Shërbimeve përkatëseve të Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 7

TERMAT E REFERENCES

- 1.** Operatori ekonomik, duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.
- 2.** Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të QSUNT. Për kryerjen e shërbimit operatori ekonomik duhet të paraqesë në periudha kohore mujore përkatëse, situacionin përmbledhës, faturat shoqëruese për sa është realizuar, proces-verbal për shërbimin e kryer, printimet e impiantit të trajtimit, dokumentacion vërtetues/ fletë shoqëruese për dorëzimin e hirit.
- 3.** Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e të dy palëve, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUNT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Ambalazhimi (kutitë, fuçitë, paletat, etj.) do të mbulohet nga subjekti fitues.
- 4.** Tërheqja dhe peshimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do bëhet periodikisht ë përcaktuar nga AK, dhe sa herë AK ka nevojë, në vendin e përcaktuar nga ky i fundit si dhe pagesa do të bëhet në bazë të kilogramëve të tërhequra sipas proces-verbaleve të firmosur nga të dyja palët. Pas evadimit të mbetjeve Operatori duhet të realizojë dezinfektimin e ambientit, të pasqyruara me proces-verbal.
- 5.** Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga operatori ekonomik.
- 6.** Subjekti duhet të furnizojë AK sa herë që kryen evadimin e mbetjeve ose cdo fillim muaji me kontenierë njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmase (sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore.
- 7.** Marrësi në dorëzim, cdo muaj, i dërgon dorëzuesit (QSUNT) një konfirmim me shkrim për realizimin e asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, bashkëlidhur dhe kopje të printimeve të impiantit të trajtimit
- 8.** Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit
- 9.** Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht një makinë të vërtetuar me certifikatë pronësie dhe të ketë sinjalistikën përkatëse për transport të mbetjeve të rrezikshme spitalore si dhe të jetë i pajisur me leje për transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.
- 10.** Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve. Dokumenti i transferimit të mbetjeve, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a. numrin e dokumentit të dorëzimit;
 - b. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;

- c. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
- ç. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
- d. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve; dh. përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasitë respektive;
- e. hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimet e tyre.

11. O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit dhe për këtë të dorëzojë cdo muaj, pranë sektorit, dokumentacion vërtetues/ fletë shoqëruese të dorëzimit të hirit pranë subjektit të licencuar.

12. Subjekti duhet të ketë **Leje Mjedisi të Tipit A (Kat. 5.1.a)** sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, e lëshuar nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe **License III.2.B** të lëshuar nga QKB për Trajtim mbetje spitalore.

13. Subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën **ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018.**

Në rast së subjekti i trajton mbetjet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

1. Leje Mjedisi e Tipit B (stacion transferimi mbetjesh të rrezikshme)', sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", i ndryshuar, lëshuar nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit.

2. Në rastë së subjekti nuk i trajton mbetjet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë duhet të mbajë proces verbal për etapën e parë të punës që është ndarje, klasifikim, mbledhja, paketimi i mbetjeve, si edhe etapa e dytë e ngarkimit, transportit, eksportin e mbetjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Në rast eksporti të këtyre mbetjeve kërkohet leja e qarkullimit ndërkombëtar dhe licenca ADR për transport të mbetjeve të rrezikshme. Në rast mundësie të transportit ndërkombëtar, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke u referuar në Konventën e Bazelit, subjekti duhet të ketë Autorizimet përkatëse.

4. Ndarja-Klasifikimi-Paketimi-Etiketimi i mbetjeve citostatike/citotoksike do bëhet në fuçi dhe/ose thasë, dhe /ose kontenier, 1A2 approved, të etiketuara me shenjën e mbetjeve citostatike citotoksike, sipas procedurave të miratuara nga BE. Gjithashtu duhet të etiketohen dhe markohen sipas direktivave të ADR "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme", nga personeli i firmës që do të bëjë asgjësimin e tyre.

5. Mbetjet citostatike dhe citotoksike do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve, ku do hartohet procesverbali për sasinë e peshuar (pa përfshirë ambalazhin, kontenier, fuçi, thasë, paletë), në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të këtij proces verbali mbeten në QSUT, dhe një kopje e merr sipërmarrësi. Pas peshimit, mbetjet ambalazhohen në kutitë përkatëse për t'u transportuar nga operatori.
6. Ngarkimi në kamion do të supervizohet nga një inxhinier i fushës, staf i firmës si dhe personat përgjegjës të QSUNT.
7. Transporti do të realizohet pas miratimit të lejes së lëvizjes ndërkufitare nga autoritetet përkatëse në Shqipëri dhe në vendin ku do të eksportohen këto mbetje.
8. Autorizimet e eksportit, për trajtimin e këtyre mbetjeve duhet të jenë të miratuara nga Ministrinë e Mjedisit të të dyja palëve të vëndeve dhe do të jenë në përputhshmëri me konventën e Baselit 1989, si dhe rregullores Europiane 1013/2006.
9. Të gjitha dokumentacionet doganore do të jenë përgjegjësi e subjektit.

Shpërndarja: 12 muaj nga nënshkrimi i Marreveshjes Kuadër.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" Tirane

Argumentimi: *Termat e referencës janë vendosur në bazë të shkresës nr. 870/6 prot., datë 05.05.2023 nga Komisioni i argumentimit të fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike, bashkëlidhur kërkeses për hapje procedure nga Drejtoria e Shërbimeve Mbeshtetese me nr. 870/7 prot, datë 10.05.2023, të miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe në përputhje me pikën 3, germa c të nenit 15 dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.*

NJËSIA E PROKURIMIT: